

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Konferenca "Tirana Fire Safety 2026", Ministri Nufi: "Mbrotjtja civile nuk mund të ndërtohet vetëm mbi reagimin, duhet parandalim"
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/konferenca-tirana-fire-safety-2026-ministri-nufi-mbrojtja-civile-nuk-mun-i586679
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 12:12:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 12:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2c33ff3aaea94033ddf08544586e6a2d244f180f6a5ac65d1dbf6b170bee6392
TEKSTI	864b130ee1af7ba7dd977cd9d166b7e3d59ac4cff2d6cb3ef16268721c122213
PAMJA	5fb0a15fd0f1e3135bd6e5905970cca598dfc038cbca8022fe9fb175f9fe6183

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	14a30362e98fc635eecfa07fe3c0ab23962083f02df6a40c56b9c9ceb8f24d94
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/14a30362e98fc635eecfa07fe3c0ab23962083f02df6a40c56b9c9ceb8f24d94>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie Konferenca "Tirana Fire Safety 2026", Ministri Nufi: "Mbrotjtja civile nuk mund te ndertohet vetem mbi reagimin, duhet parandalim" Ministrja Shendetesise, Spahiu ne Ki fundit

Konferenca "Tirana Fire Safety 2026", Ministri Nufi: "Mbrotjtja civile nuk mund të ndërtohet vetëm mbi reagimin, duhet parandalim"



17 Shtator 2026, 14:10Sociale TEMA



"Nuk mund ta ndërtojmë mbrotjtjen civile vetëm mbi reagimin. Ne duhet të jemi po aq të fortë në parandalim, sa ç'jemi edhe në reagim". Ky ishte mesazhi që Ministri i Mbrotjtjes, Ermal Nufi përcolli gjatë fjalës së tij, në hapjen e konferencës ndërkombëtare "Tirana Fire Safety 2026", që zhvillohet në Tiranë, me pjesëmarrjen e ekspertëve, institucioneve publike, profesionistëve, akademisë dhe përfaqësuesve të industrisë së ndërtimit e teknologjisë.

Në një kohë të zhvillimit të shpejtë urban dhe ndërtimit të strukturave gjithnjë e më të mëdha e komplekse, Ministri Nufi nënvizoi rëndësinë e rritjes së standardeve të sigurisë nga zjarri. Sipas ministrit, siguria duhet të merret në konsideratë që në fazën e projektimit të ndërtesave dhe strukturave.

"Sigurinë s'mund ta marrim si të mirëqenë dhe siguria s'mund të jetë asnjëherë një mendim i mëvonshëm. Ajo duhet të projektohet që në fillim!", nënvizoi ai.

Duke iu referuar kësaj vere si një nga verat më të nxehta, Ministri Nufi bëri të ditur se deri më 9 shtator 2026, sistemi i mbrotjtjes civile është përballur me 81 raste zjarresh masive, të cilat kanë kërkuar angazhim të mbi 14,600 forcave, angazhim të gati 1,350 mjetesh tokësore dhe 180 operacione ajrore.

"Pas këtyre shifrave janë njerëz, orë pune, sakrificë dhe një përpjekje e përbashkët e Forcave të Armatosura, shërbimeve zjarrfikëse, strukturave të pushtetit vendor, Policisë së Shtetit, shërbimeve pyjore, administratave të zonave të mbrotitura, vullnetarëve dhe të gjithë aktorëve të tjerë të sistemit", u shpreh Nufi.

Ai theksoi se sistemi i mbrotjtjes civile, i orientuar nga Ligji "Për mbrotjtjen civile", vendos në qendër zvogëlimin e riskut, parandalimin, gatishmërinë, koordinimin dhe aftësinë ripërtëritëse të komuniteteve.

Ministri nënvizoi gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit mes institucioneve, ekspertëve dhe sektorit privat, pasi siguria nga zjarri kërkon standarde të qarta, projektim të sigurt, zbatim korrekt, inspektim efektiv dhe përdorim të teknologjive moderne.

"Siguria nga zjarri nuk është vetëm një detyrim teknik apo administrativ - ajo është pjesë e sigurisë publike, e cilësisë së zhvillimit urban dhe e qëndrueshmërisë së komuniteteve tona", u shpreh ai.

Ndër të tjera, Ministri i Mbrojtjes Nufi theksoi se pjesëmarrja e Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian krijon mundësi për rritjen e standardeve, trajnimin e personelit, zhvillimin e kapaciteteve të ndërveprueshme dhe përvetësimin e praktikave më të mira evropiane.

Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe institucionet e tjera, tha Nufi, “do të vijojnë të mbështesin nisma që sjellin më shumë standarde, ekspertizë, teknologji, bashkëpunim dhe kulturë parandalimi, me synimin për komunitete më të sigurta dhe më pak dëme nga emergjencat civile”.

Konferenca “Tirana Fire Safety 2026” zhvillohet për dy ditë në “Tirana International Hotel” dhe bashkon ekspertë ndërkombëtarë, profesionistë të industrisë, autoritete publike, inxhinierë, konsulentë, prodhues dhe përfaqësues të sektorit të ndërtimit.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

["Dyfisho sipërmarrjen tënde", Ibrahimaj: Mbi 1,700 biznese kanë shprehur interes, 720 në trajtim](#)

12:08 Sociale / 4 komente

[Të rinjtë u lënë vendin të moshuarve; Punësimi i pensionistëve dyfishohet në tre vjet](#)

07:56 Sociale / 2 komente

Qeveria hap thirrjen për punësimin e studentëve ekselentë, shpallen 210 vende të lira në institucionet publike!

21:02 Sociale

Zhblllokohen procedurat, Bashkia e Tiranës merr në dorëzim apartamente të reja për strehimin social, zbatohet kontributi 3% i ndërtuesve

14:40 Sociale

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.